**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM**
**TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdksh.com.al. Web://www.fsdksh.com.al

Open Procurement Albania

# DOKUMENTAT STANDARDE TË PROCEDURËS PROCEDURË E HAPUR SHËRBIM

**Me objekt:**

**“Ndërtimi i regjistrit elektronik të rekordeve të pacientit për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësorë”.**

Public Health Sector

# I. NJOFTIMI I KONTRATËS

## Seksioni 1. <u>Autoriteti Kontraktor</u>

### 1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

| | |
|---|---|
| Emri | Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) |
| Adresa | Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 8 , Tiranë |
| Tel/Fax | 00355 4 232 815 |
| E-mail | info@fsdksh.com.al |
| Adresa e Internetit | http://www.fsdksh.com.al |

### 1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

| | |
|---|---|
| Institucion qëndror | Institucion i pavarur |
| □ | □ |
| Njësi e qeverisjes vendore | Tjetër |
| □ | **X** |

### 1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po □ Jo **X**

## Seksioni 2 <u>Objekti i kontratës</u>

### 2.1 Lloji i Kontratës

| Punë | Shërbime | Mallra |
|---|---|---|
| □ | **X** | □ |

**Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”**

| Konkurs Projektimi | Shërbime Konsulence | Shërbime të tjera |
|---|---|---|
| □ | □ | □ |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**2.1.2 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po ☐ Jo **X**

**2.1.3 Lloji i Marrëveshjes Kuadër**

**Me një Operator Ekonomik** ☐

**Me disa operatorë ekonomikë** ☐

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** **Po** ☐ **Jo** ☐

**2.1.4 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër:___________(*Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër*).**

Open Procurement Albania

| | | |
|---|---|---|
| **2.1.5** | Kushtet që do të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike. | |

**2.1.6 Autoriteti kontraktor / Autoritetet kontraktore, të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: ________________________________________________________________**

________________________________________________________________

Public Health Sector

**2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër**

1. 1.Fondi limit **137,542,644** (njëqindetridhjeteshtatëmilion e pesqindedyzetedymije e gjashtëqindedyzetekatër)lekë pa tvsh.
   1. Burimi i Financimit : FSDKSH-Fondi

**1.** 2. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: **"Ndërtimi i regjistrit elektronik të rekordeve të pacientit për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësorë".**

**2. 3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **<u>muaj</u> ose ditë 45(dyzet e pese)**

ose

duke filluar nga ☐☐/☐☐/☐☐☐☐ me përfundim në ☐☐/☐☐/☐☐☐☐

2.3.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

| |
|---|
| **Kohëzgjatja në muaj:** □□ *ose* **ditë:** □□□□ **(nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër***(jo më shumë se (4) vjet***)**<br>*Ose* **duke filluar nga** □□/□□/□□ **(dd/mm/vvvv)**<br>**Përfunduar më** □□/□□/□□ **(dd/mm/vvvv)** |

**2.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekt i kontratës/marrëveshjes kuadër:**

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Rruga “Sami Frashëri”, nr.8, Tiranë.

**2.5 Ndarja në Lote:**

Po □ Jo **X**

Open Procurement Albania

*Nëse po,*

**2.6 Përshkrim i shkurtër i loteve**

(Objekti dhe fondi limit i loteve)

1______________________________________

2.______________________________________

3.______________________________________

etj.

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.7 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme *(nëse ka)*: □□

Ose: nga □□ në □□

Public Health Sector

**2.8 Do të pranohen variantet:**

Po □ Jo **X**

**2.8.1 Do të pranohet nenkontraktimi:**

Po **X** Jo □

**Nese do te lejohet nenkontraktimi,** te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: me pak se 40%

Autoriteti kontraktor do t’i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po ☐ Jo **X**

**Shenime te tjera**

**2.9. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit:**

Po ☐ Jo ☐

**2.10. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po ☐ Jo ☐

**Seksioni 3** **<u>Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik</u>**

**3.1 Kriteret e Pranimit sipas shtojcës 7.**

**3.2 Sigurimi i Ofertës (** i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor**)** Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3.

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, për secilin nga Lotet është si më poshtë:
Loti 1 ______ Lekë
Loti 2 ______ Lekë

Open Albania
Public Health Sector

**Seksioni 4** **<u>Procedura</u>**

**4.1 Lloji i procedurës:** E hapur

**4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**
A) **çmimi më i ulët X**

*Ose*

B) ☐ **oferta ekonomikisht më e favorshme** ☐

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐☐ **pikë**☐

etj. ☐☐ **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

**4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**
Data: **19/10/2016 Ora: 11:00**

Vendi: Vendi: **www.app.gov.al**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al**

**4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**
Data: **19/10/2016 Ora: 11:00**

Vendi : **www.app.gov.al**

**Informacioni mbi ofertate paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150** *(e shprehur në ditë)*

**4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Shqip **X** Anglisht ☐
Tjetër ______________

**Seksioni 5** **Informacione plotësuese**

**5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):**

Open Albania
Public Health Sector

Po ☐ Jo ☐

*Nëse Po*

Monedha _________ Çmimi _______

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), adresa Rruga "Sami Frashëri", Nr 8 Tiranë, Tel/Fax 00355 4 274 753

Prokurim elektronik ne websitin zyrtar te Agjencise se Prokurimit Publik (APP-se): https://www.app.gov.al

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **24.09.2016**

## II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

### Seksioni 1. <u>Hartimi i ofertës</u>

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertes duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.

1.5 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formulari i Ofertës, plotësuar sipas Shtojcës 1 të DT.

b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
___________ ,
___________ ,
___________ .

c) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 8

ç) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

1.6 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

1.7 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të

Open Procurement Albania
Public Health Sector

vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për kryerjen e __________shërbimeve; Nr e Njoftimit _______________
**"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA __________ (dd/mm/vv) orës ______".**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.**

1.8 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **"MODIFIKIM OFERTE"** ose **"TËRHEQJE OFERTE".**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund te modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpara përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.**

**Seksioni 2 <u>Përllogaritja e ofertës ekonomike</u>**

2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të ekzekutohen dhe çmimin e tyre.

2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.

2.4. Në rastin e nje marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkurrimi midis operatorëve ekonomikë, palë në marreveshjen kuadër.

2.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

2.6 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare
b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.7 **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Për sa kohë nuk ka skaduar afati kohor për vlefshmërinë e ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

**2.8** Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

**Seksioni 3. <u>Vlerësimi i ofertave</u>**

**3.1 Kriteret e përzgjedhjes**

**(Opsioni 1)** Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

**(Opsioni 2)** Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

Po= Pk1+Pk2+Pk3+.....

Ku:

Public Health Sector

Po - jane pikët totale të ofertës së vlerësuar
Pk1/Pk2/Pk3/... - jane pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1/Ok1$$

| | |
|---|---|
| Pk1 _____ | Pikët e kriterit që vlerësohet |
| Vmin k1 | Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet |
| Pmaxk1 | Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet |
| Ok1 | Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet |

**Sqarim**
Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

Në rastin e prokurimit të marrëveshjes kuadër, kur objekt i kësaj marrëveshje janë biletat e transportit ajror ndërkombëtar, në vend të çmimit do të përdoret marzhi i fitimit i shprehur në përqindje.

### 3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar*.

### 3.3 Ofertat anomalisht të ulëta

3.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me shërbimet e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.3.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta
$M_O$ – Mesatarja e Ofertave të vlefshme
n – Numri i Ofertave të vlefshme
$Z_M$ – Zbritja e Mundshme

$$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$$

$$Z_M = 85\ \%\ Mo$$

**Vlera e Ofertës që vlerësohet <ZM.......... , <u>si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët</u>**

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

3.3.3 Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

Open Albania Public Health Sector

**Seksioni 4. <u>Nënshkrimi i kontratës</u>**

**4.1 Njoftimi i fituesit**

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 14. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

**4.2 Sigurimi i kontratës**

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 19 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
- i. garanci bankare,
- ii. garanci sigurimi,

**Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.**

**4.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar**

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Public Health Sector

**Shënim**: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

**III. SHTOJCAT**

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës
Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë (në rastin e Marrëveshjes Kuadër)
Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik
Shtojca 6: Deklaratë për konfliktin e interesit
Shtojca 7: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
Shtojca 8: Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore
Shtojca 9: Specifikimet teknike
Shtojca 10: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
Shtojca 11: Sherbimet dhe Grafiku i ekzekutimit
Shtojca 12: Termat e Referencës
Shtojca 13. Formulari për Njoftimin e Skualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Shtojca 15: Formulari i Njoftimit te operatorëve ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
Shtojca 16: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Shtojca 17: Kushtet e Veçanta të Kontratës
Shtojca 18: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar
Shtojca 18/1: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës
Shtojca 20: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor
Shtojca 21: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

**FORMULARI I OFERTËS**

Emri i Ofertuesit____________________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; me TVSH

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Përshkrimi i Shërbimeve** | **Sasia** | **Çmimi Njësi** | **Çmimi Total** | **Afati** |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| **Çmimi Neto )** | | | | | |
| **TVSH (%)** | | | | | |
| **Çmimi Total** | | | | | |

Nënshkrimi i ofertuesit _______________

Vula _______________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Shënim:
Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____( e kerkuar ne dokumentat e tenderit)

**Shtojca 2**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*]

**FTESA PËR OFERTË**

(*shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor*)

fton për të paraqitur oferta  në procedurën për kryerjen e shërbimeve të mëposhtme: …………………………………………………………………………………………………… …………………………………………………………………………………………………… ……………………………………………………………………………………………………
(*jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasise siç përkufizohet në Dokumentat  e Tenderit (DT).*

Vendi i kryerjes së shërbimit
*(jepni një përshkrim të shkurtër)*

Kohëzgjatja e shërbimit ______________________

Oferta duhet të paraqitet
……………………………………………………………………………………………………
[*Jep adresën e saktë*]
Përpara
……………………………………………………………………………………………………
[*Përcaktoni datën dhe orën përfundimtare*]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

Forma e komunikimit:

Me shkrim __                                        Elektronik ( email, fax etj.) _____

**Shtojca 3**

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _______]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

Open Procurement Albania
Public Health Sector

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 4**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti*]

**LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL**

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 5**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë __________________ nga Autoriteti Kontraktor_________________ me objekt _____________ me fond limit ___________.

Unë i nënshkruari ________________,me cilësinë e ________ të personit juridik ________________deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _________________

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

V ula

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 6**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

| |
|---|
| Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:<br><br>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat,Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.<br><br>Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.<br><br>Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005). |
| Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.** |

Unë i nënshkruari ____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik ______________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**
____________________________

Vula

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 8 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore ,
te lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere (pikat 1,2) duhet te vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në te cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit te leshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:**

**a.** Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

**b.** Prokura e posaçme.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;
b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;
ç. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1

d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë.**

Kjo pike e kritereve plotesohet me ”kriteret e pergjitheshme të Pranim/Kualifikimit” të plotesuara më sipër.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

a) Deklaratë për xhiron mesatare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare, kjo mesatare nuk duhet të jetë më pak se 100% të vlerës së fondit limit.
b) Kopje të një bilanci të 3 (tre) viteve të fundit financiare të konfirmuar nga autoritetet përkatëse.
c) Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per sherbime te mepareshme te ngjashme me objektin e prokurimitme vlere jo me te vogel se 40% e vleres se perllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit.
Kontratat e ngjashme te jene te shoqeruara me vertetimin e realizimit nga autoritete kontraktor ose subjekte private te paraqiten faturat perkatese tatimore te shitjes ku shenohen datat ,shumat dhe sasite e sherbimeve te realizuara
d) Deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka, lëshuar jo më parë se 10 ditë nga data e hapjes së ofertave, që vërteton se operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një shumë jo më të ulët se 10% të vlerës së fondit limit.
e) Një vërtetim nga furnizuesi i energjisë elektrike, që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

**2.3.Kapaciteti teknik:**

Për realizimin e shërbimeve, kompania duhet të plotësojë disa kritere teknike specifike që janë si më poshtë:

-Operatori Ekonomik duhet të ketë një marrëdhënie partneriteti dhe duhet të ketë (të paraqesë) minimum një certifikatë Gold nga prodhuesit e njohur botërorë të teknologjisë softëare të kërkuar në kapitullin “ Kërkesat Teknike”, të aneksit teknike. Certifikata GOLD duhet të ketë lidhje vetëm me objektin e këtij prokurimi. Kjo duhet të dëshmohet nëpërmjet dokumentave origjinale ose kopjeve të noterizuara.

-Operatori Ekonomi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001, 14001, 18001, 20000, 27001 ose më e përditësuar. Për plotësimin e kësaj kërkese ofertuesit duhet të paraqesin Certifikatat përkatëse, të cilat duhet të jenë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e produkteve/shërbimeve që prokurohen.

-Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 10 (dhjete) veta personel teknik të kombinuar , Inxhinier të diplomuar në fushën Teknologji Informacioni ose Informatikë, për të cilët duhet të

Open Procurement Albania
Public Health Sector

paraqesin, kopje të noterizuar të diplomës, CV, certifikata dhe kontratat e punës. Inxhinierët duhet të jenë pjesë e stafit të operatorit ekonomik, minimumi 6 muajt e fundit, kjo e dëshmuar me lispagesat , E-sig 025, të certifikuar nga organet tatimore.

Lista e personelit kryesor:

- Minimumi dy punonjës me certifikime MCPD, ose versione të përditësuara, të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose njësia edukimi e akredituar nga prodhuesi.
- Minimumi dy punonjës me certifikime Biz Talk Server MCTS, të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose njësia edukimi e akredituar nga prodhuesi.
- Minimumi dy punonjës të certifikuar nga prodhuesi për implementimin e bazës së të dhënave sipas teknologjisë së bazës së të dhënave të kërkuar në kapitullin “ Kerkesat Teknike” dhe minimumi një person të certifikuar për implementimin në cluster të bazës së të dhënave në kapitullin “ Kërkesat Teknike” . Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose njësia edukimi e akredituar nga prodhuesi.
- Minimumi dy punonjës të certifikuar nga prodhuesi për suportin e bazës së të dhënave sipas teknologjisë së bazës së të dhënave të kërkuar në kapitullin “ Kërkesat Teknike”. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose njësia edukimi e akredituar nga prodhuesi.
- Minimumi dy punonjës të certifikuar nga prodhuesi për mbështetjen e përgjithshme të teknologjisë sipas teknologjise software të kërkuar në kapitullin “ Kërkesat Teknike”. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose njësia edukimi e akredituar nga prodhuesi.
- Minimumi dy persona të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL)
- Minimumi dy persona specialist IT të çertifikuar për Certified System Administrator për Menaxhimin e Sistemeve Operative si Microsoft, Linux, UNIX etj
- Minimumi dy persona specialist IT të çertifikuar për ekspert të sigurisë në rrjet.
- Të paktën një menaxher projektesh të certifikuar në fushën e menaxhimit të projekteve (Project Management Professional PMP) ose ekuivalent, me experience jo me pak se 5 (pese ) vjecare.
- Minimumi një person teknik të certifikuar nga prodhuesi për zhvillim software-i në ambjent Oracle PL/SQL. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesit.
- Minimumi një person teknik nga prodhuesi për zhvillim software-i në ambjent Oracle Forms dhe Reports. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesit.
- Minimumi një person teknik të certifikuar nga prodhuesi për serverin e aplikimeve të tipit SOA - Oracle Weblogic. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose njësia edukimi e akredituar nga prodhuesi.
- Minimumi një person teknik të certifikuar nga prodhuesi si “Specialist i Certifikuar Implementimi” për implementimin e sistemeve me arkitekture SOA. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesit
- Minimumi një person teknik të certifikuar nga prodhuesi si “Specialist i Certifikuar Implementimi” për implementimin e sistemit Oracle Business Intelligence. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesit.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

- Te paraqesin CV, diplomat dhe Kontratat e punës afati i të cilave të jetë brenda afatit të realizimit të shërbimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt _______________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilësinë ___________të operatorit ekonomik ____________________ deklaroj se:

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Shtojca 9

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

# 1. HYRJE

## **1.1.** Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Fondi i Siguriit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetsor (më poshtë FSDKSH), qytetarët, profesionistët e shëndetit, Ministria e Shendetesise (më poshtë ministria).

## **1.2.** Historiku

Programet informatike ekzistuese te FSDKSH janë programe informatike te qenderzuar me komunikim të ndërsjelltë midis tyre .

Arkitektura e programeve informatike të FSDKSH, krijon kushtet per realizimin e sherbimeve elektronike për shtetasit, çka do të lehtësonte aksesimin e të dhënave shëndetësore dhe do të rriste transparencën për shtetasit.

Programet informatik te fondit jane transformuar  në:

- Sisteme informacioni të përqëndruara
- Sisteme informacioni të sigurte dhe të besueshme
- Sisteme informacioni të mbështetura dhe të hapura ndaj standarteve më të përparuara në fushën e teknologjisë së informacionit, vecanërisht në fushën e standarteve të mjeksisë dhe shëndetësisë.
- Sisteme informacioni të shkallezueshme (zgjerueshem)

## **1.3.** Situata Aktuale në Sektor

FSDKSH ka ne perdorim nje sere sistemiet informatike :

| **Programet Informatike ekzistuese** | **Ku përdoret** | **Përse përdoret** | **Platforma/ Teknologjia** |
|---|---|---|---|

Open Procurement Albania
Public Health Sector

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Sistemi i regjistrimit të recetave** | Ky sistem përdoret nga Fondi, Drejtoritë Rajonale, Agjensitë | Ky program informatik përdoret për rregjistrimin e recetave me rimbursim në Drejtoritë Rajonale. Realizon bashkimin e këtij informacioni në Drejtoritë Rajonale dhe Fond dhe menaxhimin e tij, si dhe mundëson nxjerrjen e konsumit të Fondit dhe raporte të tjera lidhur me to. Ky informacion i shërben drejtorive të Fondit për pagesa, parashikime dhe kontrollet e farmacive dhe mjekëve. | SQL, VB |
| **Programi informatik i DEPO-ve farmaceutike** | Depo Farmaceutike me kontratë me Fondin | Ky program informatik për rregjistrimin e faturave hyrëse e dalëse në Depot Farmaceutike me kontratë me Fondin, si dhe realizon nxjerrjen e raporteve të nevojshme. Ky informacion u shërben drejtorive të Fondit për të bërë kontrollet e Depove Farmaceutike. | Microsoft Access |
| **Programi informatik eFARMACI** | Farmaci me kontratë me Fondin | Ky program informatik për rregjistrimin e faturave hyrëse dhe recetave me rimbursim të farmacive me kontratë me Drejtoritë Rajonale të Fondit. Ky informacion u shërben drejtorive te Fondit për të bërë kontrollet e farmacive dhe pranimin e recetave ne Drejtoritë Rajonale. | Oracle |
| **Sistemi informatik i regjistrimit te kartes se shendetit** | Qëndra Shendetësore, Drejtoritë Rajonale , Fondi | Ky program informatik ben te mundur regjistrimin e kartave te shendetit per shtetasit shqiptar dhe shtetasit e huaj qe jane rezidente ne republiken e shqiperise | Oracle |
| **Program informatik për Kostot e Spitaleve** | Spitale Rajonale e Bashkiake me kontratë me Fondin | Ky program informatik shërben për regjistrimin e informacionit të kostos së spitaleve, sipas kartelave të pacientëve të shtruar, shpenzimet direkte, shpenzimet indirekte dhe pagat e stafit të spitaleve. Mundëson | SQL, Microsoft Access |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | nxjerrjen e raporteve dhe indikatorëve. Ky informacion u shërben Drejtorive Rajonale dhe Fondit për kontrollin e këtyre spitaleve si dhe për përgatitjen e buxhetit dhe stratëgjisë në financimin e spitaleve nga Fondi. | |
| **SISHP(S**istemin i **I**nformacionit **Sh**endetsor ne **P**aresor) | Qëndra Shendetësore, Drejtoritë Rajonale , Fondi | Ky program informatik shërben për regjistrimin e formularëve të vizitave të mjekëve dhe infermierëve në QSH dhe nxjerrjen e raporteve përkatëse. Ky informacion u shërben QSH dhe drejtorive të FSDKSH për matjen e aktivitetit të ofruesve, llogaritjen e indikatorëve të perfomancës së QSH-ve. | SQL, Microsoft Access |
| **Sistemi Informatik i shpenzimeve Spitalore** | Qëndra Shendetësore, Drejtoritë Rajonale , Fondi | Ky program informatik shërben regjistrimin e shpenzimeve spitalore | Oracle |
| **Sistemi informatik i menaxhimit te financiar dhe burimeve njerzore** | Qëndra Shendetësore, Drejtoritë Rajonale , Fondi | Ky program informatik menaxhimit te financiar dhe burimeve njerzore te FSDKSH | Oracle |
| **Sistemi informatik i recetes elektronike** | Qëndra Shendetësore, Drejtoritë Rajonale , Fondi, farmacite e qarkut Durres | Ky program informatik ben te mundur pershkrimin dhe dispensimin e receteve ne menyre elektronike per qarkun e Durresit | Oracle |

Por aktualisht prane FSDKSH nuk ka nje regjister elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit qe te beje te mundur shfaqjen dhe shfletimin e informacionit ne menyre uniforme dhe te perqendruar.

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

Open Procurement Albania Public Health Sector

## 2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Përmirësimi i shëndetit dhe kujdesit shëndetësor për të gjithë shtetasve nëpërmejt përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit duke rritur aksesin e sigurtë të shtetasve në të dhënat personale klinike shëndetësore.

## 2.2. Qëllimi

Programi i qeverisë për shëndetësinë thekson se “Informacioni për shëndetin, treguesit e shëndetit dhe kujdesin shëndetësor, lidhja e tyre me tregues bazë socialë, në nivel individual dhe kombëtar është i mangët, i pasaktë, i fragmentarizuar dhe jo koherent. Për pasojë, edhe vendimmarrja realizohet në mënyrë joprofesionale. Do të ngremë një sistem unik dixhital shëndetësor, me të cilin do të ndërlidhen të gjithë aktorët e sistemit shëndetësor, publikë dhe privatë. Në qendër të sistemit do të jetë individi dhe dosja e tij elektronike shëndetësore. Dixhitalizimi i informacionit për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor do të përdoret edhe për të rritur ndjeshëm transparencën në komunikimin me publikun për gjendjen e shëndetit të popullatës, për përdorimin e burimeve të disponueshme, për të filluar zbatimin e standardeve të llogaridhënies së hapur të zyrtarëve publikë dhe të ofruesve të shërbimit si dhe të vendosjes së besimit midis popullatës, ofruesve të shërbimit dhe zyrtarëve të lartë.”
Investimi që kërkohet përputhet me këtë prioritet të programit të qeverisë. Për më tepër brenda vitit 2015 do të filloje të funksionojë projekti i recetës elektronike në rrethin e Durrësit. Projekti i recetës elektronike për të gjithë Shqipërinë është një nga programet e Ministrisë së Shëndetësisë. Në PBA 2015-2017, ky program është tërësisht i financuar.

Nepermjet ketij regjisteri elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit synohet te arrihen

Qëllimi I: Arritja e përshtatshmërisë dhe Shkëmbimit të Informacionit nëpërmjet përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit

Qëllimi II: Përmirësim i kujdesit shëndetësore dhe ulja e kostove në shëndetësi nëpërmjet përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit

Qëllimi III: Frymëzimi i konfidencës dhe besimit në sistemet e teknologjisë së informacionit

Qëllimi IV: Furnizimi dhe fuqizimi i shtetasve me sisteme të tëknologjisë së inormacionit për përmirësimin e sistemit të kujdesit shëndetësor

## *2.3.* Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori

Autoriteti Kontraktor duhet të realizojë ndërtimin e regjistrit elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit.

Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do të përmbajë komponentët e mëposhtme:

- Informacion mbi të dhënat demografike të pacientit

Open Procurement Albania
Public Health Sector

- Informacion mbi të dhënat e shenjave jetësore pacientit
- Informacionit mbi të dhënat e vizitave të pacientit prane mjekeve te familjeve dhe mjekeve specialiste.
- Informacionit mbi të dhënat mbi historikun e diagnozave të pacientit
- Informacion mbi të dhënat mbi historikun e mjekimeve dhe barnave mjeksore që ka përdorur pacienti duke identifikuar dhe farmacinë në të cilën bari është dispensuar.
- Informacion mbi të dhënat mbi historikun e ekzaminimeve mjekesore.

# 3. SUPOZIMET DHE RISQET

## 3.1. Supozimet e Projektit

- Informacioni i shkëmbyer midis stafit të palëve mbetet konfidencial mes palëve
- Stafi i autoritetit kontraktor do të vërë në dispozicion të personelit të operatorit ekonomik të gjithë dokumentet, rregulloret, procedurat e nevojshme për realizimin e rregullave të biznesit objekt i këtij projekti.
- Stafi i autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të punojë në një ambient me kultura të ndryshme dhe disiplina të ndryshme pune dhe kulturore.
- Stafi i autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jetë i pavarur në punën e tij dhe i gjindshëm në çdo rast.
- Stafi i autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jetë komunikues dhe të jetë pozitivë në mënyrën e mendimit.
- Stafi i autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të gjejë konsensusin në rastet kur kërkohet.

## 3.2. Rrisqet

- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e mos koordinimit të punës mes pjesëtarëve të grupit të punës pranë FSDKSH.
- Nivel i ulët bashkëpunimi midis pjesëtarëve të grupit të punës pranë FSDKSH.

# 4. QËLLIMI I PUNËS

## 4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore: LIGJ Nr. 10 383, datë 24.2.2011

“PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I ndryshuar dhe shtuar me:

Open Albania Public Health Sector

- Ligjin Nr. 126/2013, datë 25.4.2013, "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, 'Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë' ";

- Ligjin Nr. 184/2013, datë 28.12.2013, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, 'Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar";

- Ligjin Nr. 141/2014, datë 23.10.2014, "Për disa shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, 'Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".

- Ligjin Nr. 145/2015, datë 17.12.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, 'Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".

### 4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Qëllimi i kësaj kontrate permbledh sa me poshte vijon:

- Krijimin dhe ndërtimin e regjisteri elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit qe do të përmbajë komponentët e mëposhtëm:
  - Informacion mbi të dhënat demografike të pacientit
  - Informacion mbi të dhënat e shenjave jetësore pacientit
  - Informacionit mbi të dhënat e vizitave të pacientit prane mjekeve te familjeve dhe mjekeve specialiste.
  - Informacionit mbi të dhënat mbi historikun e diagnozave të pacientit
  - Informacion mbi të dhënat mbi historikun e mjekimeve dhe barnave mjeksore që ka përdorur pacienti duke identifikuar dhe farmacinë në të cilën bari është dispensuar.
  - Informacion mbi të dhënat mbi historikun e ekzaminimeve mjekesore
- Nderveprim me sistemet e tjera egzistuese
- Trajnimin e stafit e FSDKSH

### 4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Republika e Shqiperirse

### 4.1.3. Grupet e synuara

- Shtetasit e Republikës se Shqipërisë dhe të huaj që marrin shërbim mjekësor në Shqipëri
- Profesionistët e shëndetit
- FSDKSH

Open Procurement Albania
Public Health Sector

#### *4.1.4.* Siguria e sistemit

- Do të sigurojë akses të sigurtë.
- Sistemi i sigurisë do të mbështetet minimalisht në mekanizmat e përdorues/fjalëkalim.
- Sistemi i sigurisë do të mbështetet mbi role informatike në sistem që i vihen në korrespondencë roleve funksionale, institucionale të përdoruesve të këtij sistemi. Do të realizohet përcaktimi i grupeve të përdoruesve sipas roleve;
- Çdo përdoruesi do t'i caktohen në sistem nivelet e të drejtave dhe aksesi mbi informacionin (lexim, shkrim, modifikim).
- Sistemi do të ketë një nivel të lartë sigurie dhe disponueshmërie. Do të garantohet disponueshmëri e lartë e funksionimit të sistemit dhe sigurisë së të dhënave.

### *4.2. Detyrat specifike*

Kontaktori ka si detyra për realizimin e projektit :

- Ndertimin e regjistrit elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit
- Instalim dhe konfigurim te regjistrit elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit
- Testimin e funksionaliteteve te regjistrit elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit
- Ndertimin e nderveprimit me sistemet e tjera egzistuese pershkruar ne seksionin 1.3
- Lëvrim i trajnimi për stafin e FSDKSH

## 5. LOGJISTIKA DHE KOHA

### **5.1.** Vendndodhja

Infrastruktura eksistuesse hardware dhe software e Fondit te Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.

### **5.2.** Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

– Si datë fillimi e projektit do të merret “Data e nënshkrimit të kontratës” dhe koha totale e ndertimit dhe venies ne pune te sistemit do jetë 45 (Dyzet e pese) dite

## 6. RAPORTIMI

### **6.1.** Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në <shqip> në origjinal dhe në <2 (dy)> kopje:

Open Procurement Albania
Public Health Sector

- **Raporti Fillestar** prej maksimumit 12 faqesh duhet të prodhohet pas <1(një) jave> nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** i faqeve maksimale <20 (njëzet)> (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset) Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 2(dy) jave para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuara nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është <5 (pesë)> ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar mbi <Sistemin e Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave>. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

### 6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

Në procedurat e centralizuara, si një praktikë standarde përfituesi duhet të përfshihet në komentet dhe miratimin e raporteve. Në mungesë të komenteve ose miratimit nga përfituesi brenda afatit të caktuar, raportet konsiderohen të aprovuara.

## 7. Komunikimi me sisteme të tjerë

- Me regjistrin e Gjendjes Civile për të dhënat e shtetasve shqiptare – aktualish operacionale prane FSDKSH
- Me AKBMP për regjistrin e barnave të regjistruar në Republikën e Shqipërisë - aktualish operacionale prane FSDKSH
- Me ISSH për të dhënat e pensionistëve - aktualish operacionale prane FSDKSH
- Me DP Tatimeve per te dhenat e punesimit - aktualish operacionale prane FSDKSH
- Me SHKP ( Sherbimi Kombetar i Punesimit ) per te papunet - aktualish operacionale prane FSDKSH

Te gjithe nderveprimet e mesiperme do te duhet te perdoren per te furnizuar me informacionin e kerkuar Regjistrin Elektronik te Rekordeve Shendetesore te Pacienteve.
Te gjitha nderveprimet e mesiperme jane te implementuar duke perdorur platformen qeveritare te nderveprimit ESB .

Open Albania
Public Health Sector

Sistemi duhet te jene ne perputhje me artiktekturen ESB (Platformen unike qeveritre te nderveprimit) prane AKSHI.

Nderveprimi nepermjet platformes unike qeveritare te nderveprimit do të lejoje shkëmbimin e mesazheve elektronike ndërmjet Government Gateway dhe sistemeve të brëndshme backend. Infrastruktura mbeshtetese qe sherben per te shkembyer informacion me Platformen Qeveritare te Nderveprimit eshte DIS (Department Integration Server).

Detyra e ESB është që ta rrugëzojë imformacionin e plotësuar drejt sistemit backend te institucionit. Dërgimi i këtyre te dhenave te publikuara te me web service do të realizohet nëpërmjet postimit prej sistemit te regjistrit drejt ESB. Te dhenat dërgohen si XML drejt ndërfaqes së ESB. Me qëllim që të njihet prej ndërfaqes publike të ESB, ai fillimisht duhet të mbështillet nga një mesazh me format të përcaktuar, të quajtur GovTalk. Mesazhi i XML tashmë i mbështjellë nga GovTalk duhet të nënshkruhet nga "Timestamp" e rrjetit qeveritar, i cili do të japë sigurinë për kohës reale në të cilën është dërguar mesazhi. Pas mbërritjes në ESB, mesazhi rrugezohet në sistemin "backend" të institucionit nëpërmjet DIS të saj. Janë konfigurimet e kryera për shërbimin ato që duhet të sigurojnë këtë rrugëzim. DIS duhet të interpretojë mesazhin e ardhur në formatin GovTalk, të lexojë prej tij vetëm elementin "Body" që përmban XML-në e formularit dhe ta dërgojë atë drejt sistemit duke konsumuar një "web service" që duhet të zhvillohet enkas për këtë qëllim. Nëse mesazhi do të jetë i "enkriptuar" me firmë dixhitale, atëherë është pikërisht ky DIS i cili duhet të të suportojë funksionin e dekriptimit të mesazhit dhe të verifikimit të firmës dixhitale. Të gjitha këto funksione të DIS duhet të realizohen nëpërmjet librarisë së integrimit në serverin përkatës të DIS.

## 8. Garancia

Nuk Aplikohet

Open Data Albania
Public Health Sector

## 9. MIRËMBAJTJA

**<u>Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë 4 vjet, në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit".</u>**

**Shërbimet e Mirëmbajtjes**
Kompania duhet të ofroje shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë.

(a) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-t e listuar në tabelën e listës së furnizimeve. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime pro aktivë të

cilat do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit .Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë AUTORITETI KONTRAKTOR, përveç rasteve kur AUTORITETI KONTRAKTOR përcakton një vendndodhje të re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

(b) Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e AUTORITETIT KONTRAKTOR) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të " Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar i AUTORITETI KONTRAKTOR ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëhershme e të konsiderueshme të sistemit dhe që, nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i AUTORITETI KONTRAKTOR dhe të rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet që nuk i përkasin "Alarmeve Madhore", duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. AUTORITETI KONTRAKTOR do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Operatori ekonomik duhet të kontaktojë AUTORITETI KONTRAKTOR dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i AUTORITETI KONTRAKTOR. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, AUTORITETI KONTRAKTOR do të vërë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting nga operatori ekonomik, dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. AUTORITETI KONTRAKTOR do të kooperojë me kërkesën e operatorit ekonomik për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet Informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atëherë ajo duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë AUTORITETI KONTRAKTOR brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga AUTORITETI KONTRAKTOR dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autoritetit kontraktor, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

(iii) Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit. Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa (a) Alarmi madhor të jetë korrektuar ose të jetë "zgjidhur në mënyrë të tërthortë", (b) tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër, (c) Operatori ekonomik të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose (d) Operatori ekonomik arrin në konkluzion që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Teknikët e shërbimit të kompanisë duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndër vepruar në mënyrë direkte me prodhuesit.
Operatori ekonomik duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin e Autoritetit Kontraktor për çdo ndërhyrje.

Kompania duhet të krijojë / diskutojë me AUTORITETI KONTRAKTOR një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

Mujore

a. Kontroll i logeve të serverave
b. Kontroll i statistikave të storage (Used disk space etc)
c. Kontroll i statistikave për programe
d. Kontroll i disqeve për problem në rast nevoje
e. Të kryejë mirëmbajtje proaktive.
f. Rishikim i të dhënave mbi përformancë e serverave

Open Procurement Albania

**Kategorizimi i problemeve dhe koha e përgjigjes**

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre gjatë periudhës së mirëmbajtjes

| **Serioziteti 1 ( Kritik/ i Lartë)** | **Serioziteti 2 (I Mesëm)** | **Serioziteti 3 (I Ulët)** |
|---|---|---|
| **Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrimet financiare** | | |
| Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare të mëdha për përdoruesit ose rrezikon shumë aktivitetin ekonomik të përdoruesve | Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare të konsiderueshme për përdoruesit ose rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik të përdoruesve | Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime financiare minimale për përdoruesit ose rrezikon në mënyrë minimal aktivitetin ekonomik të përdoruesve |
| **Pezullimi i punës** | | |
| Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre. | Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre, por ata janë në gjëndje të realizojnë pjesën tjetër. Mund të përfshijë gjithashtu pyetje dhe përgjigje për informacion. | Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë një pjesë të vogël të punës së tyre, por ata janë në gjëndje të realizojnë pjesën tjetër |
| **Numri i përdoruesëve të ndikuar** | | |

Public Health Sector

| | | |
|---|---|---|
| Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve | Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të vogël të përdoruesve | Mos funksionimi i aplikacionit ndikon në 1 (një) ose 2 (dy) përdorues |
| **Zgjidhje alternative e përkohëshme**[Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2] | | |
| Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit (p.sh. puna nuk mund të realizohet në një mënyrë tjetër) | Mund të ketë ose jo një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit. | Potencialisht ekziston një mënyrë alternative e përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit. |
| **Koha e përgjigjes** | | |
| Brenda një ore | Brenda 8 (tetë) orëve | Brenda 8 (tetë) orëve ose ditën tjetër të punës. |
| **Koha e zgjidhjes** | | |
| Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë të vazhdueshme pas kontaktit të parë. | Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 20 ditëve të vazhdueshme të punës. | Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 45 ditë kalendarike. |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

# 10.Planifikimi i Buxhetit për Ndërtimin e Sistemit

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Përshkrimi i Shërbimeve** | **Njesia** | **Sasia** | **Cmimi per Njesi (Leke)** | **Cmimi Total** |
| 1 | Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit | Sistem | Pa kufizim perdoruesish | | |
| 2 | Trajnim | Dite | 5 | | |
| 3 | Mirembajtje(SLA) | vite | 4 | | |
| | **Vlera pa TVSH** | | | | |
| | **TVSH** | | | | |
| | **Vlera Totale me TVSH** | | | | |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

## 11.Koha e implementimit

| Nr. | Emërtimi i fazës / Periudha kohore | J1 | J2 | J3 | J4 | J5 | J6- | Viti1-Viti4 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Faza përgatitore për Regjistrin elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit | *x* | | | | | | |
| **3** | Faza e zhvillimit | | *x* | *x* | *x* | | | |
| **4** | Faza implementimit | | | | *x* | *x* | | |
| **5** | Faza e integrimit dhe testimit | | | | | | *x* | |
| **6** | Trajnimi i përdoruesve | | | | | | *x* | |
| **7** | Fillimi i SLA | | | | | | | *x* |

## 12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Çdo e drejtë mbi kodin burim i zhvilluar nga operatori kontraktor apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me sistemin të ndërtuar nga kontraktuesi duhet t'i kalojë përfituesit në format elektronik dhe në letër.

## 13. Kërkesa Funksionale

Objekti i ketij prokurimi  eshte ndërtimi i regjistrit elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit me ate te cilit do të bëhet e mundur shfaqja e të gjithë historikut të shëndetit të pacientit.

Do të bëhen të mundur mekanizma informatike të cilat do të realizojnë mbledhjen e informacionit nga burime të ndryshme dhe paraqitjen e këtij informacioni në regjistrin elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit.

Regjisteri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do te duhet te permbaje komponentët e mëposhtëm:

- Informacion mbi të dhënat demografike të pacientit
- Informacion mbi të dhënat e shenjave jetësore pacientit
- Informacionit mbi të dhënat e vizitave të pacientit prane mjekeve te familjeve dhe mjekeve specialiste.
- Informacionit mbi të dhënat mbi historikun e diagnozave të pacientit
- Informacion mbi të dhënat mbi historikun e mjekimeve dhe barnave mjeksore që ka përdorur pacienti duke identifikuar dhe farmacinë në të cilën bari është dispensuar.
- Informacion mbi të dhënat mbi historikun e ekzaminimeve mjekesore

Open Albania
Public Health Sector

Regjistri elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit, do te duhet te pasqyroje të dhënat shendetesore te pacienteve

Ndërtimi i regjistrit elektronik te rekordeve shendetesore te pacientit i cili do te duhet te bëjë të mundur paraqitjen dixhitale e informacionit shëndetësor për pacientët , për të rritur eficencën, për të rritur cilësinë e shërbimit dhe për të ulur koston.

Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do te duhet te mbajë rekorde mbi shëndetin e pacientëve të cilat do të mund të aksesohen në rrjet nga të gjitha palët e interesuara duke përfshirë Institucionet e shëndetit: Qëndrat shëndetësore; Institucionet Publike, punonjesit e FSDKSH,, Shtetasit: Pacientët.

Avantazhet e ndërtimit të një regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do te duhet te përmblidhen në:

Open Procurement Albania

- Mjekët e kujdesit shëndetësor do te duhet te ketë mundësinë e konsultimit dhe përditësimit online të dosjes së pacientit
- Rekordi i regjistrit elektronik të do te duhet te mbajë informacion për :
    - Të dhënat demografike të pacientëve.
    - Te dhenat e kartes se shendetit te pacienteve
    - Të dhënat mbi ecurinë e mjekimit të pacientëve
    - Të dhënat e egzaminimeve mjekesore të pacientëve.
    - Të dhënat mbi recetat dhe barnat mjekesore që pacienti merr aktulisht dhe historikun e barnave te marra .
- Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do te duhet te ofrojë mundësinë që të dhënat shëndetësore të pacientit të mund të akesoshen online midis institucioneve të ndryshme shëndetësore duke perdorur nderveprim nepermjet platformes unike qeveritare te nderveprimit.

Public Health Sector

- Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do te duhet te ofrojë mundësinë e standartizimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor.

Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do te duhet te ofrojë mundësinë mjekëve dhe personelit mjekësor që :

- Të dokumentojë të gjithë ndërveprimet dhe marrëdhëniet me pacientët.
- Të mund të shfletojnë historikun mjekësor të pacientëve
- Te mund te ofrojë akses online për shtetasit për shfletim dhe regjistrimin e vizitave mjeksore në parësor
- Mundësinë e shfletimit dhe regjistrimin të referimeve për mjekë të tjerë.
- Të japin dhe të regjistrojnë rekomandime për analiza mjeksore dhe t'i shfletojë këto rezultate.

Objektivat kryesore të Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit përfshijnë:

- Përmirësimin e cilësisë, sigurisë , eficencës të të dhënave të kujdesit shëndetësor duke reduktuar kostot.
- Nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Rekordeve Shëndetësore mjekët dhe stafi i institucioneve shëndetësore do të mund të rrisin koordinimin nëpërmjet aksesimit online të informacionit shëndetësor

Çështjet që duhet te adresoje regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit permbledhin:

- Përsosmëri në kujdesin shëndetësor
- Akses në informacionin e nevojshëm  në qëndrat e kujdesit shëndetësor
- Rritje e mbikëqyrjes  dhe politikave rregullatore
- Menaxhim i stafit në mënyrë proactive
- Kush është pacienti im ?
- Ku ndodhet?
- A ka ardhur më parë te unë?
- A ka pacienti një historik klinik tek unë?
- A i kam të disponueshme kurat mjeksore dhe resultet e egzaminimeve mjekësore?
- A mund t’i aksesoj kurat dhe rezultatet e egzaminimeve mjekësore të pacientit ?
- A mund ta shpërndaj informacionin që kam mbi pacientin me mjekë të tjerë ?

| • **Grupet e interesit** | Cështje që duhet te adresohen ne regjistrin elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit |
|---|---|
| Qendrat e Kujdesit Shendetesor / Mjeku | Akesim i shpejt dhe konsisten i të dhënave të pacientit.<br><br>Mundësi për shkëmbim informacioni në sistemin e kujdesit shëndetësor.<br><br>Mundësi komunikimi midis mjekëve nëpërmjet sistemit për pacientët.<br><br>Ulje ngarkese e punës administrative<br><br>Akses në të dhënat mjeksore për pacientët<br><br>Akses te recetat dhe barnat e marra nga pacientet |
| FSDKSH | Lehtësi me aksesin e informacionit mbi menaxhueshmërinë e institucioneve shëndetësore.<br><br>Lehtësi me aksesin e informacionit mbi efikasitetit e përdorimit të resurseve në institucionet shëndetësore. |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

| | |
|---|---|
| | Akses i informacionit në real-time nëpërmjet paraqitjeve tip business intelligence nëpërmjet Dashboardeve<br><br>Vendimarrje e saktë per manaxhimin dhe mbikqyrjen financiare mbi bazën e informacionin e saktë mbledhur në real time.<br><br>Hartim politikash të sakta mbi bazën e informacionit tashmë të aksesueshëm online. |
| | Rritje e transparencës.<br><br>Rritje e ndërveprueshmërisë së sistemeve të teknologjisë së informacionit midis instituciove të ndryshme shëndetësore<br><br>Mundësia e krijimit statistika në nivel kombëtar për popullsinë .<br><br>Ulja e kostove të shërbimit të kujdesit shëndetësor. |
| Pacienti | Rritje e aksesit të pacientit në shërbime elektronike në historikun e tij mjekësor.<br><br>Mundësinë e zgjedhjes së institucionit për marrjen e kujdesit shëndetësor nga vetë pacienti. |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Sistemi duhet te jete i tipit web based, teresisht arkitekture software e mbeshtetur ne WEB.
Duhet te kete nje nderfaqe te thjeshte,te lehte dhe intiutive ne perdorim.
Duhet te kete nje nderfaqe GUI per percaktimin e perdoruesve te sistemit dhe per percaktimin e roleve.
Duhet te kete kerkim te indeksuar sipas medatave te regjistruara te te dhenave te Regjistrit.
Duhet te kete mundesine e kerkimit me ane te fushave te ndryshme.
Duhet te ofroje mundesi integrimi me ane te web services.
Duhet te jete ne gjuhe shqipe.
Te suportojë mundesinë e punës në konfigurim me shperndarje ngarkese ne konfigurim aplication serverash Active-Active.
Tesuportojë REST.
Te kryeje ekspozim te rezultateve te kerkimit duke perdorur mekanizma të tipit kashe
Te kete funksione monitorimi te integruara ne apllication server
Te lejoje ekspozim dhe orkestrim te web serviceve
Te kete ruajtje, shfletim, shfaqje te logeve të mesazheve që shkëmbehen në runtime.
Te suport per ambjente heterogjene shkembimi te te dhenave.

Regjistri i elektronik i rekordeve shendetesore te pacienteve duhet te ofroje dhe nje aplikim :

a) browser based mobile application
b) mobile app  (iOS dhe Android )

Duke ofruar funksionalitetet si me poshte:

- Informacion mbi të dhënat demografike të pacientit
- Informacionit mbi të dhënat e vizitave të pacientit prane mjekeve te familjeve dhe mjekeve specialiste.
- Informacionit mbi të dhënat mbi historikun e diagnozave të pacientit
- Informacion mbi të dhënat mbi historikun e mjekimeve dhe barnave mjeksore që ka përdorur pacienti duke identifikuar recetat mjekesore dhe farmacinë në të cilën bari është dispensuar.
- Informacion mbi të dhënat mbi historikun e ekzaminimeve mjekesore

**Operatori ekonomik në propozimin e tij teknik, duhet t'i përgjigjet të gjitha kërkesave teknike dhe funksionale të projektit, duke parashtruar zgjidhjen teknike të realizimit të çdo kërkese teknike dhe funksionale.**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

### 13.1. Komponentë Trajnimi

Trajnim i stafit te FSDKSH per administrimin dhe mbajtje ne kushte operacionele regjistrin elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit.

### 13.2. Raporte

Raportet do të përcaktohen nga një grup punë midis operatorit ekonomik fitues dhe zotëruesit të projektit, gjatë fazës përgatitore të projektit. Operatori ekonomik fitues do të duhet minimalisht të ndërtojë 10 raporte ne ambjentin e BI (Business Intelligence) qe FSDKSH disponon, sipas kërkesave dhe nevojave të FSDKSH.

## 14. KËRKESAT TEKNIKE

### 14.1. Komponente Hardware

Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do te duhet te instalohet ne infrastrukture hardware dhe software qe FSDKSH disponon.

Per regjistrin elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit FSDKSH do te vere ne dispozicion keto komponente hardware

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 2 | Server Blade (Web server + Application server) me Sistem Operativ Linux 64bit x86 | copë | 4 |
| 4 | Server Rack-mount (DB) me Sistem Operativ Linux 64bit x86 | copë | 2 |
| 5 | SAN Storage (për DB Server ) - Nje LUN me madhesi 1TB | copë | 1 |

### 14.2. Komponentë Software

Regjistri elektronik i rekordeve shendetesore te pacientit do te duhet te instalohet dhe te operoje ne infrastrukture software ekzistuese qe FSDKSH disponon.

Komponentet Software

- 2 Servera aplikimesh - Oracle Weblogic Server Standard Edition 12c
- 2 Servera DIS (Microsoft SQL Server, IIS , Biztalk Server) per nderveprim
- 1 Server Business Intelligence (Oracle Business Intelligence Standard Edition One 11g)
- 2 Servera për database (Oracle Datavase Server Enterprise Edition 12c me Oracle Real Application Cluster 12c)

Open Procurement Albania
Public Health Sector


Open
Procurement
Albania
Public Health Sector

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I**
**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Shëerbim: ☐ Mall: ☐ **Punë:**
Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____

| Kontrata Nr. | Titulli i Kontratës | Përshkrim i shkurtër i kontratës |
|---|---|---|
| 01 | __________ | _______________ |
| 02 | __________ | _______________ |
| 03 | __________ | _______________ |
| … | __________ | _______________ |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 11**

(*Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet**: Sipas specifikimeve teknike, shtojca 9

**Afatet e ekzekutimit:** 45 (dyzet e pese) ditë

Open Albania
Public Health Sector

**Shtojca 12**

(*Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:
Sipas specifikimeve teknike, shtojca 9

Detyrat:
Sipas specifikimeve teknike, shtojca 9

Shpërndarja:
Sipas specifikimeve teknike, shtojca 9

Vendi  i kryerjes së shërbimeve:
Sipas specifikimeve teknike, shtojca 9

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 13**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR[1]**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

________________________________________
________________________________________
________________________________________
________________________________________
________________________________________
________________________________________
________________________________________

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
**< Emri >**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

[1] Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**Shtojca 14**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data________]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*
Procedura e prokurimit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera _____________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera __________________________
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.___________________________

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
___________________________________________________________________________
___________________________________________________________________________
___________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ____________________________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 15**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga  Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*

1. ________________________________________

*2.* ________________________________________

*3.*________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  çmimi më i ulët □ oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1.________________________________  ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë*  *numri i NIPT-it*

Vlera ____________________________

*(me numra dhe fjalë)*

2.________________________________  ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë*  *numri i NIPT-it*

Vlera ____________________________

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.____________________________

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1.________________________________  ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë*  *numri i NIPT-it*

2.________________________________  ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* __________________*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Open Albania
Public Health Sector

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ______________________________/ Pikët totale të marra ________________

*(me numra dhe fjalë)*

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera _____________________________/ Pikët totale të marra _________________

*(me numra dhe fjalë)*

Etj._______________________________

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo_______________

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ____________________________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 16**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES**
**Shërbimet – Procedura e Hapur**

**Neni 1 Qëllimi**

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruara me anë të procedurës së hapur.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2 Përkufizime**

2.1 "Kontratë" do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.4 "Palë (t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.5 "Autoriteti Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 "Kontraktues" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

2.7 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

2.8 "Termat e References" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojne detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3 Hartimi i Kontratës**

3.1 Shpallja e fituesit do të sherbejë per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

**Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Open Procurement Albania Public Health Sector

**Neni 6 Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuara ne përgjithsi.

7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha sherbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.

11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.

11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

**Neni 12 Vendndodhja**

12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.

12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet ne mënyrë të paarsyeshme.

**Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

**Neni 14 Çmimi i Kontratës**

14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 15 Afatet e Pagesës**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhen në kohë siç specifikohet në kontratë.

15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

15.5 Data e pagesës do të jëte dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

16.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.

16.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) te provoje ndonje dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dëm me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

**Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

17.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 18 Forca Madhore**

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

**Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar**

20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates..
c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates...

**Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet**

21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë doreheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 22 Ndryshimi i Porosisë**

22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim**

23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

**Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 26 Nënkontrata**

26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësine e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

26.3 Cdo nenkontraktor duhet të kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 27 Transferimi i të Drejtave**

31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 28 Sigurimi i Kontrates**

28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.

28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

**Neni 29 Baza Ligjore**

29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 31 Përfaqësimi i Palëve**

31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 32 Lajmërimet**

32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 33 Llogaritja e Afateve**

33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 17**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## KUSHTET E VEÇANTA
## Shërbimet – Procedura e Hapur

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

**Neni 1 Përkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor është

1.2 Kontraktuesi është

**Neni 2 Sigurimi i kontratës**

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* ________________________________________ duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:

**Neni 3 Fillimi i Kontratës**

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të filloje më __________. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

**Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve**

4.1 Shërbimet do të kryhen në:

**Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

Open Albania
Public Health Sector

5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

**Neni 6 Kërkesat e Raportimit**

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm:

Open Procurement Albania

**Neni 7 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon:

Public Health Sector

**Neni 8 Kushtet e Pagesës**

8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:

8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _________ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

8.3 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

**Neni 9 Pagesa Paraprake**

9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: ________________________________

**Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës**

10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë ____________________________________________________________________________
____________________________________________________________________
Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 18**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR**

**Seksioni I** **<u>Autoriteti Kontraktor</u>**

**I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri _____________________________________________
Adresa _____________________________________________
Tel/Fax _____________________________________________
E-mail _____________________________________________
Adresa në Internet _____________________________________________

**I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

| Institucion Qëndror | Institucion i Pavarur |
|---|---|
| □ | □ |
| Njesite e Qeverisjes Vendore | Tjetër |
| □ | □ |

**Seksioni 2** **<u>Objekti i Kontratës</u>**

**2.1 Lloji i Kontratës**

| Punë | Shërbime | Mallra |
|---|---|---|
| □ | □ | □ |

**Lloji i "Kontratave Publike për Shërbime"**

| Konkurs Projektimi | Shërbime Konsulence | Shërbime të tjera |
|---|---|---|
| □ | □ | □ |

**2.1.2 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuader**

Po □ Jo □

**Nëse Po, lloji i Marreveshjes Kuadër**

**Me 1 Operator Ekonomik** □

**Me disa operatorë ekonomikë** □

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara**

Po □ Jo □

**2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1 Fondi limit ________________________________________________

2. Burimi i Financimit ________________________________________

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër __________________________________________

**2. 3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **muaj** □□□ **ose ditë** □□□□

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

**2.4 Ndarja në LOTE:**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Po □ Jo □

*Nëse Po*, numri i LOTEVE*:* □□

**2.5 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka): □□

ose: nga □□ në □□ □□□

**Seksioni 3 Procedura**

**3.1 Lloji i procedurës:**

E hapur

□

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **çmimi më i ulët** □

*ose*

B) **oferta ekonomikisht□ më e favorshme** □

lidhur me rëndësinë: Çmimi □□ **pikë**□

etj. □□ **pikë**

**3.3 Numri i ofertave të dorëzuara:**□□□□□

**Numri i ofertave të rregullta:**□□□□□

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushen e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqërise së Informacionit:**

Po □ Jo □

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të paaplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit**

Po □ Jo □

**Seksioni 4 Informacion mbi kontratën**

**4.1 Numri i Kontratës: _______________Data e Kontratës** □□/□□/□□□□

**4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri _____________________________________________



Open Procurement Albania
Public Health Sector

Adresa ____________________________________________
Tel/Fax ____________________________________________
E-mail ____________________________________________
Adresa e Internetit ____________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet dhe opsionet)*:

Vlera _______________ *(pa TVSH)* Monedha __________
Vlera _______________ *(me TVSH)* Monedha __________

**4.4 Informacione shtesë**

_____________________________________________________________________________
______________________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi □□/□□/□□□□

Open Procurement Albania Public Health Sector

**Shtojca 18/1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ____________________________________________
Adresa ____________________________________________
Tel/Fax ____________________________________________
E-mail ____________________________________________
Faqja në Internet ____________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ____________________________________________**

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër_______________________**

**4. Fondi limit ____________________________________________**

**5. Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet dhe opsionet)*:

Vlera ________________ *(me TVSH)* Monedha __________

**6. Data e lidhjes së kontratës ____________**

**7. Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Nr. NIPT ____________________________________________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 19**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

[Data ________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Ne Emer te: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës ]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Open Procurement Albania

**Shtojca 20**

## FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

***Ankesë drejtuar:*** ***Autoriteti Kontraktor*** ☐

Public Health Sector

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërish).*

______________________________________________

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

______________________________________________

Adresa

| | | |
|---|---|---|
| ____________ | ____________ | ____________ |
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Kodi Zip |

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Open Procurement Albania

**Seksioni II. Informacion për Procedurën**

1. **Numër Identifikimi**
*Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë **llojin e procedurës së përdorur** për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

2. **Autoriteti Kontraktor**
*Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Public Health Sector

3. **Vlera e Përllogaritur e Prokurimit**
*Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

**4. Objekti i Kontratës**

*Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.*

**5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës**

*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

Data (viti/muaji/dita)

**6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese**

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Open Procurement Albania

## Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

**1. Baza Ligjore e Ankesës**

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

**2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve**

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

Public Health Sector

**3. Lista e Shtojcave**

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht* ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj .*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet t'i referoheni Formularit të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

**Nr. Faks:**
**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 21**

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR**
( KU TE GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
**PER PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

[Përdorimi i ketij draft marrëveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

**Nr __**

**DATA:**

Kjo Kontratë është lidhur më [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] të përfaqësuar nga [*përfaqësuesi*], tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [*data*] bie dakord të furnizoje mallrat, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Draft marrëveshje
- Formulari i Deklarimit te Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i marreveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/sherbimeve/puneve në vijim.

[përshkrimi i përgjithshëm]

1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje. P.sh. kurdoherë që Autoriteti Kontraktor i përfshirë në këtë marreveshje, do të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato te parashikuara.

1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t’i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 **Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër**

________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra /shërbime janë treguar në Formularin e Cmimit të Ofertës.

2.2 Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t’i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

**Nënshkrimet dhe Datat**

| **Për Kontraktuesin** | | **Për Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shtojca 22**

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR**

**( KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)**
**PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

**Emri i Autoritetit Kontraktor,**
Dhe

**Emri i Kontraktuesit**

Bien dakord si vijon:

**Të nënshkruajnë këtë marrëveshje kuadër për Kryerjen e:** < vendosni titullin > me numrin identifikues : <*vendosni Numrin e Prokurimit*>

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i kësaj marreveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkursit vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

1.2 Kjo marrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

1.3 Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë kontraktuesit "Ftesën për Ofertë" kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdo që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër**

3.1 Kontratat do të nenshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrencës**

4.1 Procesi i mini- konkursit do të kryhet me të gjithe operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë /mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mall /shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Oferte dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër**

___________________________________

**Nënshkrimet dhe datat**

| **Për Furnizuesin** | | **Për Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri :** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |


Open
Procurement
Albania
Public Health Sector